

VENDIM
Nr.652, datë 6.8.2010

**PËR NJË SHITESË FONDI, NË BUXHETIN E VITIT 2010, MIRATUAR PËR
MINISTRINË E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT, PËR PAGESËN E
DETYRIMEVE PËR ENERGJI ELEKTRIKE TË SHOQËRIVE TË UJËSJELLËSVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 4, 43, 44 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe neneve 13 e 16 të ligjit nr.10 190, datë 4.12.2009 “Për buxhetin e viti 2010”, dhe propozimin e Ministrisë të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, në buxhetin e miratuar për vitin 2010, në programin “Ujësjellës-Kanalizime”, shpenzime korrente, t’i shtohet fondi prej 1 730 000 000 (një miliard e shtatëqind e tridhjetë milionë) lekësh, për pagesën e detyrimeve për energji elektrike, të shoqërive të ujësjellësve, sipas lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ky fond të përballohet si më poshtë vijon:

- 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë nga pakësimi në programin “Strehimi dhe urbanistika”, shpenzime korrente, i miratuar në buxhetin e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit.

- 1 200 000 000 (një miliard e dyqind milionë) lekë nga fondi i kontigjencës i buxhetit të shtetit.

- 500 000 000 (pesëqind milionë) lekë nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

3. Për pagesën e detyrimeve për energji elektrike, të shoqërive të ujësjellësve, sipas lidhjes 1 të këtij vendimi, të përdoret dhe fondi i padetajuar prej 340 000 000 (treqind e dyzet milionë) lekësh, nga zëri subvencione për ujësjellës, miratuar në buxhetin e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit.

4. Shuma e paguar për detyrimet e energjisë elektrike të shoqërive të ujësjellësve, që i korrespondon detyrimeve për energji elektrike të këtyre shoqërive, të zbritet nga transfertat e pakushtëzuara të vitit 2010, të njërive të qeverisjeve vendore, ku këto shoqëri ushtrojnë veprimtarinë e tyre.

5. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

TABELA SIPAS AKT RAKORDIMEVE NDËRMJET OSSH DHE SH.A.UK	
Emërtimi i shoqërisë	Detyrimet progresive për
	energjinë deri 30.6.2010 në 000/lekë
Ujësjellës Sarandë	32 535
Ujësjellësi Vau i Dejës	6 306
Ujësjellësi Tropojë	27 692
Ujësjellësi Krujë	157
Ujësjellësi Berat	433

Ujësjiellësi Lezhë	63 836
Ujësjiellësi Elbasan Qytet	78 489
Ujësjiellësi Shkodër Qytet	185 040
Ujësjiellësi Përmet	203
Ujësjiellësi Vlorë	228 327
Ujësjiellësi Durrës	808 480
Ujësjiellësi Novosel	21 805
Ujësjiellësi Shkodër Fshat	24 986
Ujësjiellësi Elbasan Fshat	91 617
Ujësjiellësi Korçë Fshat	18 668
Ujësjiellësi Lushnjë Fshat	8 554
Ujësjiellësi Gjirokastrë Fshat	115
Ujësjiellësi Bilisht	5 697
Ujësjiellësi Mirditë	8 088
Ujësjiellësi Rrogozhinë	5 462
Ujësjiellësi Fier	79 962
Ujësjiellësi Fushë-Krujë	10 378
Ujësjiellësi Kavajë	22 564
Ujësjiellësi Mallakastrë	3 598
Ujësjiellësi Gjirokastrë Qytet	1 432
Ujësjiellësi Lushnjë Qytet	28 497
Ujësjiellësi Libohovë	301
Ujësjiellësi Selenicë	8 901
Ujësjiellësi Peqin	10 860
Ujësjiellësi Gramsh	104
Ujësjiellësi Kuçovë	18 148
Ujësjiellësi Bulqizë	17 148
Ujësjiellësi Tepelenë	25 607
Ujësjiellësi Poliçan	4 878
Ujësjiellësi Has	12 378
Ujësjiellësi Çorovodë	4 728
Ujësjiellësi Kukës	9 439
Ujësjiellësi Kurbin	62 751
Ujësjiellësi Delvinë	9 493
Ujësjiellësi Ura Vajgurore	9 206
Ujësjiellësi Krastë	23
Ujësjiellësi Patos	88 871
Ujësjiellësi Këlcyrë	5 814
Ujësjiellësi Orikum	500
Ujësjiellësi Kamëz	17 929
Shuma totale	2 070 000